



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 34 prot.

Kamëz, më 23 . 4 .2025

V E N D I M

Nr. 30 .Datë 23/ 4 2025

MBI

**“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË DHE NGA FONDI 6% I BLOK -NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.04.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.25 Datë 18.04.2025 në mbështetje të nenit 24, , të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 57, datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime” në VKM nr. 597 datë 04.09.2019, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 855 datë 29.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, neni 4, neni 5, neni 6 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 119 dt. 19.12.2024 “Mbi detajimin e buxhetit” për vitin 2025, 2026, 2027”; VKB nr. 10 datë 24.01.2025 mbi “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë” për vitin, 2025, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike për **231** familje me një fond prej **1,733,000 (njëmiljon e shtatëqind e tridhjetë e tremijë) lekë për muajin Prill 2025**. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Listën e muajit **Mars 2025**, prej **63** familje që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **376,317(treqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë**.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI